

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6772
E premte, 2 dhjetor 2022
çmimi 0.40

Begaj vlerëson
kontributin e Gjermanisë
në procesin e dialogut
Kosovë - Serbi | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ | FAQE 4-5

QEVERIA E HUTUAR, OPOZITA E ÇAKORDUAR

Sekretari i përgjithshëm i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ka deklaruar se kryeministri Albin Kurti në minutat e fundit dhe pas një presioni të jashtëzakonshëm euro-amerikan, e pranoi kërkesën që më parë e kishte refuzuar, por dëmet tashmë janë shkaktuar dhe ato do të na ndjekin edhe për një kohë. Nitaj nuk është i sigurt se dialogu do të rifillojë me propozimin euro-amerikan që tashmë njihet si plani franko-gjerman. Ai thotë se Kosova do të vihet para një sfide tjetër, krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Nitaj thotë se vendit po i mungon një front i bashkuar opozitar



OPINION

MË 28 NËNTOR TË GJITHË
PO BËHEN PATRIOTË,
O BACA ADEM, EDHE ATA
TË 29 NËNTORIT! | F. 6-7

Behxhet Sh.
SHALA – BAJGORA



AKTUALE



KËTË VIT NË KOSOVË JANË
RAPORTUAR 15 RASTE ME HIV
INFEKSION DHE DY RASTE
ME AIDS | F. 6

NENAD RASHIQI EMËROHET
MINISTËR PËR KOMUNITETE
DHE KTHIM | F. 3

EKONOMI



BQK-ja: BANKAT KOMERCIALE
PËR 10 MUJ FITUAN
MBI 120 MILIONË EURO | F. 8

KOSOVA DHE MAQEDONIA
E VERIUT PRITET TA THELLOJNË
BASHKËPUNIMIN NË BUJQËSI | F. 8

SPORT

ELIMINOHET GJERMANIA, KUALIFIKOHEN
JAPONIA DHE SPANJA | F. 10

GRUAJA E VRARË NË PRISHTINË KISHTE URDHËR PËR MBROJTJE

Gjykata Themelore në Ferizaj ka konfirmuar se gruaja shtatzënë, që është vrarë të mërkurën në oborrin e Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë, ka pasur urdhër për mbrojtje. Sipas vendimit, urdhri për mbrojtje i ishte lëshuar për gjashtë muaj, përkatësisht prej 13 gushtit të këtij viti deri më 13 mars të vitit të ardhshëm. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se në momentin që verifikohet se cila hallkë institucionale ka dështuar, do të ketë dorëheqje ose shkarkim



PE SYNON
PËRMBYLLJE
TË SHPEJTË
TË PROCESIT PËR
LIBERALIZIMIN
E VIZAVE | FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Begaj vlerëson kontributin e Gjermanisë në procesin e dialogut Kosovë - Serbi

IRANË, 1 DHJETOR - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka pritur të enjten në takim presidentin e Republikës Federale të Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, në vizitën e parë të një presidenti gjerman në Shqipëri në 27 vjetët e fundit. Begaj ka theksuar se për Shqipërinë dhe shqiptarët Gjermania është vend mik dhe partner i pazëvendësueshëm. "Gjermania na ka mbështetur në të gjitha nivelet: politik, diplomatik, ekonomik, në rrugëtimin euroatlantik, demokratizimin e vendit dhe stabilitetin e rajonit. Mbështetja për reformat e integritetit evropian, reformën në drejtësi, në policinë e shtetit, si dhe mbështetja financiare në sektorë

të rëndësishëm të ekonomisë, si energjia, arsimit profesional, mjedisi e më gjerë, ka qenë e pandërprerë dhe gjithmonë e vlerësuar maksimalisht nga ne", ka theksuar Begaj. Ai ka falënderuar presidentin Steinmeier për rolin vendimtar që luajti Gjermania për mbajtjen e Konferencës Ndërqeveritare dhe hapjen e negociatave për anëtarësim me BE-në në korrik të këtij viti. "Ne e mirëpresim rolin dhe kontributin e Gjermanisë në proceset integruese të Ballkanit Perëndimor si dhe vlerësojmë angazhimin dhe propozimin gjermano-francez për zgjidhjen e konfliktit në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe e mbështesim vijimin e dialogut", ka theksuar Begaj.



Ushtria ukrainase: Forcat ruse po sulmojnë në lindje, kanë forcuar pozicionet në jug



KIEV, 1 DHJETOR - Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase ka thënë se forcat shtetërore janë duke vazhduar luftimet në rajonin lindor Donjeck, derisa në jug trupat ruse kanë forcuar pozicionet e tyre dhe kanë bombarduar Hersonin. Forcat ukrainase kanë rikthyer kontrollin e Hersonit muajin e kaluar. Në pjesën më të madhe të Ukrainës punëtorët teknikë janë duke punuar për t'i rikthyer furnizimet me energji, pas dëmeve të mëdha në rrjet që kanë shkaktuar bombardimet ruse. Për pasojë, miliona njerëz kanë mbetur pa rrymë, teksa temperaturat sa shkojnë e ulen. Sipas ushtrisë ukrainase, Donjecku mbetet zona ku po zhvillohen luftimet më të ashpra. Sipas saj, trupat ushtarake ruse janë duke krijuar linja të mbrojtjes në drejtim të qytetës së Limanit dhe se ato janë duke u përforcuar me personel, municion dhe naftë. Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka thënë se Ukraina është duke marrë hapa shtesë për

t'i luftuar veprimet e ushtrisë ruse, por pa dhënë më shumë hollësi. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët perëndimorë janë zotuar për më shumë ndihmë financiare dhe dërgim të pajisjeve ushtarake në Ukrainë për t'i rritur kapacitetet e Kievit për luftë. Ata i kanë bërë të ditura këto qëndrime pas një takimi që kanë zhvilluar ministrat e jashtëm të NATO-s në Bukuresht. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë, në fund të takimit në Bukuresht, se strategjia e Rusisë për shënjestrim të infrastrukturës ukrainase të energjisë nuk do t'i përçajë mbështetësit e Ukrainës. Lufta në këtë shtet ka nisur më 24 shkurt të këtij viti. Presidenti rus Vladimir Putin e konsideron luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjegjës ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Vritet lideri i IS-it

DAMASK, 1 DHJETOR - Lideri i grupit militant Shteti Islamik (IS), Abu al-Hassan al-Hashimi al-Qurayshi, është vrarë në një betejë, tha zëdhënësi i grupit, duke mos dhënë më shumë detaje. Al-Qurayshi është lideri i dytë i IS-it që është vrarë gjatë këtij viti në kohën kur ky grup ekstremist po tenton që të ngrihet sërish, duke tentuar që t'i aktivizojë celulat e saj për të

kryer sulme vdekjeprurëse në Irak dhe Siri. Pak dihet për al-Qurayshi, i cili mori udhëheqjen e grupit pas vdekjes së paraardhësit të tij, Abu Ibrahim al-Hashimi al-Qurayshi, i cili u vra gjatë një aksioni të Shteteve të Bashkuara të kryer në shkurt në veriperëndim të Sirisë. Vrasja e Al-Qurayshi është një goditje ndaj grupit militant i cili u mposht në Irak më 2017

dhe dy vjet më vonë në Siri. Njoftimi i zëdhënësit të IS-it, Abu Omar al-Muhajer, vjen në kohën kur IS-i po tenton të kryejë sulme vdekjeprurëse në disa pjesë të Sirisë dhe Irakut, ku ekstremistët më herët e kishin shpallur një kalifat. "Ai vdiq duke luftuar armiq të Zotit, duke vrarë disa prej tyre para se të vritej si një burrë në fushëbetejë", tha al-Muhajer. Zëdhënësi tha se Abu al-

Hussein al-Husseini al-Qurayshi është emëruar udhëheqës i ri i grupit militant. Uashingtoni është pyetur për vrasjen e al-Qurayshit dhe zëdhënësi i Këshillit për Siguri Kombëtare, John Kirby tha: "Ne mirëpresim lajmin për vdekjen e një tjetër lideri të IS-it. Nuk kam detaje të tjera tani për tani për këtë ngjarje". Al-Qurayshi është lideri i tretë i vrarë që kur themeluesi i IS-it,



Abu Bakr al-Baghdadi, u vra nga amerikanët në tetor të vitit 2019. Askush deri më tani nuk e ka marrë përgjegjësinë për vrasjen e liderit të IS-it.

Gruaja e vrarë në Prishtinë kishte urdhër për mbrojtje

Gjykata Themelore në Ferizaj ka konfirmuar se gruaja shtatzënë, që është vrarë të mërkurën në oborrin e Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë, ka pasur urdhër për mbrojtje. Sipas vendimit, urdhri për mbrojtje i ishte lëshuar për gjashtë muaj, përkatësisht prej 13 gushtit të këtij viti deri më 13 mars të vitit të ardhshëm. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se në momentin që verifikohet se cila hallkë institucionale ka dështuar, do të ketë dorëheqje ose shkarkim

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Gjykata Themelore në Ferizaj ka konfirmuar se gruaja shtatzënë, që është vrarë të mërkurën në oborrin e Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë, ka pasur urdhër për mbrojtje. Autoritetet kanë thënë se vrasës ka qenë bashkëshorti i saj dhe viktima besohet se ishte rreth moshës 35-vjeçare. Sipas vendimit, urdhri për mbrojtje i ishte lëshuar për gjashtë muaj, përkatësisht prej 13 gushtit të këtij viti deri më 13 mars të vitit të ardhshëm.

Sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, urdhri për mbrojtje lëshohet "me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, për mbrojtjen e personit që i është ekspozuar dhunës, duke mënjanuar rrethanat që ndikojnë apo mund të ndikojnë në kryerjen e veprave të tjera".

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e ka konsideruar papërgjegjësi institucionale këtë vrasje dhe ka thënë se "sikur prokuroria të ishte në krye të detyrës, rasti i tillë do të mund të ishte parandaluar". "Viktima kishte raportuar në korrik të këtij viti të dyshuarin për dhunë psikike dhe fizike, dhe prokuroria personin e dyshuar e kishte liruar në procedurë të rregullt. Është një papërgjegjësi institucionale, është papërgjegjësi e prokurorit të rastit, sepse ne në vazhdimësi



po bëjmë thirrje që të mbrohen jetët e grave dhe vajzave. Sikur prokuroria të ishte në krye të detyrës, rasti i tillë do të mund të ishte parandaluar", ka thënë ajo. Haxhiu ka thënë se në momentin që verifikohet se cila hallkë institucionale ka dështuar, do të ketë dorëheqje ose shkarkim. "Ju garantoj, nëse shohim që ka dështuar dikush, do të ketë dorëheqje e shkarkim. Por, keni parasysh, dorëheqje dhe shkarkime janë kërkuar edhe në rastet e kaluara, kur ka dështuar

prokuroria, por asnjë dorëheqje, asnjë shkarkim dhe këto raste, mosveprimet, neglizhenca, po i inkurajon vrasësit, kriminelët", ka thënë ministria Haxhiu.

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka bërë me dije se i dyshuari për kryerjen e vrasjes është shpallur fajtor këtë vit për posedim të paautorizuar të armës dhe ka aktakuzë për veprën penale të kanosjes. Sipas komunikatës, gjykata e ka refuzuar kërkesën e të pandehurit për hedhje poshtë të aktakuzës dhe kundërshtim të provave.

Ministria Haxhiu ka thënë se Ministria e Shëndetësisë, qendrat për punë sociale dhe institucionet e tjera, kanë marrë përgjegjësi për të verifikuar çdo veprim institucional të lidhur me këtë vrasje. "Një grua, bashkë me foshnjën e saj që priste ta sillte në jetë, u vra para objektit të Gjinekologjisë. Ishte një rast i rëndë, i kobshëm, i trishtë. Ky rast na tregon sa i shprehur është femicidi që po vret jetë vajzash dhe grash. Pesë ditë, dy jetë të humbura, dy gra të vrara

nga bashkëshortët e tyre", ka deklaruar Haxhiu.

Motra e gruas shtatzënë, që është vrarë më 30 nëntor në oborrin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ka thënë për mediet se viktima ka qenë vazhdimisht viktimë e dhunës në familje. Sipas familjares së saj, viktima ka qenë e martuar për tre muaj me bashkëshortin e saj, mirëpo vazhdimisht ka qenë nën presion. "Nuk e kanë lënë që të vijë asnjëherë te shtëpia e babait që të bëhemi bashkë ne motrat". Sipas motrës së saj, viktima ishte planifikuar që ta kryente lindjen më 1 dhjetor. "Unë kam folur një ditë më parë në telefon me të dhe e kam pyetur nëse është mirë. Ajo më tha se është mirë dhe që të nesërmen do ta kryejë lindjen me operacion në orën 09:00". Ajo ka thënë se motra e saj e ka lajmëruar dhunën edhe tek autoritetet e rendit dhe ligjrisht i është ofruar mbrojtje. "Ajo ka thënë se ka mbrojtje, por askush në mbrojtje nuk i ka dalë", ka pohuar ajo.

KMDLNj: Vrasja e gruas shtatzënë, dështim i mekanizmave mbrojtës të shtetit!

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se vrasja e gruas shtatzënë që ndodhi mbrëmë në oborrin e QKUK-së është dështim i mekanizmave mbrojtës të shtetit. "KMDLNj e gjykon këtë rast si shkelje flagrante e të drejtës kryesore të njeriut, të drejtës për jetë mbi të cilën ndërtohen të gjitha të drejtat e tjera. KMDLNj vlerëson se vrasja e H. M është pasojë e drejtpërdrejtë e dështimit të mekanizmave mbrojtës të shtetit të cilat, përkundër faktit se kanë qenë të informuara për rastin, në vend se të marrin masa për mbrojtje efektive të viktimës së ekzekutuar H. M., janë mjaftuar me masa të përkohshme, të buta e që e kanë inkurajuar dorasin ta bëjë këtë krim në vend ta parandalojnë atë", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Ndaj kësaj vrasjeje ka pasur reagime të shumta nga institucionet e vendit dhe shoqëria civile. Viktima është gruaja e dytë që është vrarë në ditët e fundit në Kosovë. Më 25 nëntor është raportuar se një burrë e ka vrarë gruan e vet me sëpatë në një lagje të Prishtinës. Më 25 nëntor në Kosovë ka nisur fushata "16 ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Baza Gjinore" organizuar nga Ministria e Drejtësisë.

Policia kërkon ndihmë për arrestimin e burrit që dyshohet se vrau gruan te QKUK-ja

Policia e Kosovës ka kërkuar ndihmën e qytetarëve për arrestimin e Sokol Halilit, që dyshohet se të mërkurën në mbrëmje vrau gruan shtatzënë para Klinikës së Gjinekologjisë në QKUK. Përmes një kërkesë për bashkëpunim, së cilës ia ka bashkangjitur edhe foton e të dyshuarit, policia i ka lutur të gjithë ata që kanë ndonjë informatë që mund të çojë në identifikimin e vendndodhjes së personit të dyshuar, ta kontaktojnë policinë në numrin e telefonit 192.

Nenad Rashiç emërohet ministër për Komunitete dhe Kthim

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti ka emëruar sot Nenad Rashiçin ministër për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Republikës së Kosovës. "Kryeministri Kurti e uroi z. Rashiç për detyrën dhe përgjegjësitë e reja institucionale në Republikën e Kosovës", theksohet në njoftimin e Qeverisë së Kosovës. Kjo pozitë deri në fillim të nëntorit mbahej nga Goran

Rakiqi, i cili ka dhënë dorëheqje për shkak të vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i reregjistruar targat ilegale serbe në veri të Kosovës. Për të njëjtën arsye dorëheqje nga institucionet e Kosovës kanë dhënë edhe zyrtarë të tjerë serbë nga veriu. Vitet e fundit Rashiç ka vepruar si politikan opozitar serb në Kosovë.

Para formimit të Listës Serbe më 2013, partisë më të madhe

të serbëve në Kosovë, ai ka qenë deputet i Kuvendit të Kosovës dhe pjesë e qeverisë.

Më 2020 kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e pati emëruar Rashiçin drejtor i Zyrës për Komunitete, mirëpo ai ka dhënë dorëheqje pas ngritjes së aktakuzës ndaj tij nga Prokuroria Speciale. Ndërkohë, Gjykata Themelore në Prishtinë e ka liruar atë nga aktakuza për "keqpërdorimin e pozitës dhe autoritetit zyrtar".





FLET PËR “EPOKËN E RE”, MUHARREM NITAJ

Qeveria e hutuar, opozita e çakorduar

Sekretari i përgjithshëm i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, në një intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ka deklaruar se kryeministri Albin Kurti në minutat e fundit dhe pas një presioni të jashtëzakonshëm euro-amerikan, e pranoi kërkesën që më parë e kishte refuzuar, por dëmet tashmë janë shkaktuar dhe ato do të na ndjekin edhe për një kohë. Nitaj nuk është i sigurt se dialogu do të rifillojë me propozimin euro-amerikan që tashmë njihet si plani franko-gjerman. Ai thotë se Kosova do të vihet para një sfide tjetër, krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Nitaj thotë se vendit po i mungon një front i bashkuar opozitar

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 DHJETOR -
“Epoka e re”: Z. Nitaj, AAK-ja dhe lideri i saj ka pasur reagime të shumta sa i përket situatës për targarat ilegale në veri. Tash pas arritjes së marrëveshjes në Bruksel, si e shihni situatën?

Nitaj: Udhëheqja e Kosovës bëri gabime të mëdha për trajtimin e kësaj çështjeje. I kishte bërë hesapet gabim që në momentin e parë kur kishte refuzuar kërkesën amerikane për shtyrjen e zbatimit të marrëveshjes së targave. Dhe kjo, për fat të keq,

do të ketë kosto edhe për ta edhe për vendin. Në minutat e fundit dhe pas presionit të jashtëzakonshëm euro-amerikan, kryeministri e pranoi kërkesën që më parë e kishte refuzuar, por dëmet tashmë ishin shkaktuar dhe ato do të na ndjekin edhe për një kohë. Për fat të keq, Serbia që është përgjegjësjë kryesore për krejt faqet e zeza në veri, jo vetëm në këto 4-5 javë, por që nga viti 2000 e këtej, brenda natës u shndërrua në beniaminin e Perëndimit dhe kjo është e padrejtë. Tash situata është më e komplikuar sesa që ishte para se të hapej çështja e

targave dhe unë nuk shoh se ajo do të mund të qetësohet, nëse nuk do të ketë një ndërhyrje të fortë të BE-së e posaçërisht të ShBA-së.

“Epoka e re”: Tashmë është e qartë se dialogu do të rinisë me diskutimin rreth planit franko-gjerman. Këtë plan, aq sa kemi parë, AAK-ja e përkrah, sepse edhe Haradinaj ishte i vetmi nga opozita që iu përgjigj ftesës së Kurtit për takim dhe e ka parë këtë plan.

Nitaj: Nuk jam shumë i sigurt nëse do të rifillojë dialogu për propozimin euro-amerikan që

tashmë njihet si plani franko-gjerman, apo do të ketë edhe ndonjë pengesë para se të arrihet deri aty. Është e mundur që Kosova të vihet para një sfide tjetër, që është krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që do të ishte fijasko për Kosovën. Gjithmonë ky ka qenë rreziku që të futeshim në një vorbull nga e cila nuk do të mund të dilnim. Trajtimi i çështjeve të vogla teknike e “një nga një” ka qenë skenar e kurth i Serbisë që të mos arrihet kurrë të një marrëveshje për njohje me Kosovën. Prandaj ka pasur një reagim aq të fortë prej nesh e prej opinionit publik, që Kurti të mos binte në këtë kurth, e jo sepse ne nuk do ta mbështesnim vendosjen e regjimit shtetëror të targave.

“Epoka e re”: Nganjëherë jepet përshtypja se AAK-ja po i afrohet shumë qeverisë Kurti, duke pasur parasysh se Haradinaj ka ofruar përkrahje për dialogun dhe u

është përgjigjur ftesave të Kurtit, por nganjëherë aq shumë drejtohen pastaj akuza në drejtim të qeverisë. A ka diçka të vërtetë që AAK-ja të bëhet pjesë e kësaj qeverie?

Nitaj: Është gabim fatal që kryeministri i vendit, pavarësisht se cili është ai, të trajtohet me inat, aq më tepër kur bëhet fjalë për vendime që mund të përcaktojnë të ardhmen tonë si shtet e si shoqëri për shumë vjet. Opozita nuk e ka komoditetin vetëm të kundërshtojë, por edhe të bëhet pjesë e zgjidhjes. Nuk duhet fërkuar duart për dështimin e qeverisë e të kryeministrit, sepse dështimi i tij është dështim i vendit. Një kategori njerëzish kanë paguar çmim të madh për lirinë e këtij vendi dhe tash e kanë të pamundur të bëjnë sehir. Dialogu me Serbinë sot është çështje madhore dhe tema më e madhe që nga qershori i vitit 1999 dhe Kosova nuk mund t'i ketë disa palë në këtë çështje.

PE synon përmbyllje të shpejtë të procesit për liberalizimin e vizave

BRUKSEL, 1 DHJETOR - Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni Evropian pritet t'i nisin shpejt diskutimet për përmbylljen e procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Më 30 nëntor ambasadorët e vendeve të Bashkimit Evropian kanë miratuar në Këshill dokumentin për vizat, duke i dhënë mandatin Presidencës Çeke që t'i nisë negociatat në Parlament. Sipas vendimit, lëvizja pa viza për qytetarët e Kosovës do të jetë e mundur kur të hyjë në fuqi sistemi

evropian i udhëtimit, ETIAS, dhe data për këtë është 1 nëntori i vitit 2023. Por, në rast se do të ketë vonesa për këtë sistem, liberalizimi i vizave për Kosovën do të hyjë në fuqi jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024.

Deputeti holandez Thijs Reuten, i cili është emëruar raportues për çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën, do të negociojë me Këshillin në emër të Parlamentit. Ai ka thënë se do të bëjë çmos që procesi të përmbyllet sa më shpejt, ndonëse është shprehur se

vendimi i Këshillit nuk është në tërësi në përputhje me pritjet e Parlamentit. "Ky vendim do të duhej të ndodhte para shumë kohësh. Komisioni Evropian ka konfirmuar se Kosova i ka përbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave para katër vjetësh. Jo shumë kohë pas kësaj edhe Parlamenti Evropian ka miratuar të njëjtin qëndrim. Na vjen mirë që Këshilli më në fund u pajtua për t'i dhënë Kosovës mundësinë e lëvizjes pa viza, por fakti se vendet anëtare kanë

vendosur ta lidhin këtë me funksionalizimin e sistemit ETIAS-it (ose më së voni më 1 janar 2024) nuk është ajo që ne kemi pritur", ka thënë Reuten, raporton REL.

ETIAS kërkon që qytetarët e huaj, të cilët udhëtojnë pa viza në territorin e BE-së, t'i regjistrojnë të dhënat e tyre në këtë sistem para udhëtimit. Reuten ka thënë se ka synime që negociatat të nisin sa më shpejt që është e mundur, mundësisht para fundit të vitit. "Unë nuk mund të them se kur mund të përmbyllet dialogu mes tri palëve, por do të

punojmë me shumë mund që të mos shkaktojmë vonesa të tjera" ka thënë ai.

Sipas interpretimit të këtij deputeti, për të pasur mandat për nisjen e negociatave në emër të Parlamentit, nuk ka nevojë për votim të ri, sepse mund të konsiderohet si mandat edhe pëlqimi që ka dhënë Parlamenti Evropian në vitin 2019.

Kosova, aktualisht, është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në këtë zonë.



Në këtë rrafsh duhet parë përkrahjen e Aleancës dhe të Ramush Haradinajt për dialogun. E sa iu përket përshtypjeve se po i afrohem shumë ose pak qeverisë Kurti, se mos është hera e parë që përshtypjet janë të gabuara. Nuk ka asgjë të vërtetë se Aleanca mund të bëhet pjesë e kësaj qeverie.

"Epoka e re": Çfarë vlerësimi keni për qeverinë Kurti?

Nitaj: Gjatë kohës së kësaj qeverie jemi më të varfër, më të emigrueshëm, më të mërziur, më të sëmurë, më të ndarë... Ndoshta e gjithë kjo është pasojë edhe e një krize që e ka përfshirë globin, por unë si qytetar jam i

pakënaqur me rolin e kësaj qeverie për zbutjen e kësaj krize.

"Epoka e re": Si sekretar i përgjithshëm i AAK-së, si është organizimi i sotëm i AAK-së në nivel vendi?

Nitaj: Aleanca e ka përfunduar me sukses një proces të zgjedhjeve të brendshme. Ka arritur që t'i funksionalizojë disa degë, që nuk kanë qenë aq funksionale. Ka një trend të rritjes. I janë bashkuar plot njerëz që më parë nuk kanë qenë pjesë e saj. Kryetari Haradinaj e ka zhvilluar një tur diskutimi me qytetarë në pothuaj të gjitha qytetet e Kosovës. grupi Parlamentar, sado që me numër jo të madh

deputetësh, ka qenë funksional, i zëshëm dhe ka shtyrë plot nisma me interes për publikun. Kryetarët e komunave që qeverisen nga Aleanca kanë pasur një performancë të jashtëzakonshme, në shumë raste duke qenë kampionë në qeverisje transparente. Aleanca është rreshtuar drejt e me kohë në të gjitha proceset e rëndësishme për vendin. Të gjitha këto e bëjnë Aleancën një parti serioze e të strukturuar. Natyrisht asgjë nuk ka të përkryer dhe ne jemi në një proces të vazhdueshëm të shtrirjes sonë më të madhe.

"Epoka e re": Shpesh kritikohet opozita se nuk është duke e

luajtur rolin e vet opozitar përballë këtij pushtet. A mendoni se opozita do të duhej të ishte më e koordinuar në veprime, jo vetëm në deklarime?

Nitaj: Vlerësoj se kritikohet me të drejtë. E vërteta është se sot nuk ka një front të bashkuar opozitar. Opozita është copa-copa dhe kjo nuk e ndihmon as opozitën e as qeverinë, besa as vendin. Kur opozita është e çakorduar, ka rrezik që vendi të rrëshqasë në diktaturë. Përtej modestisë, kujtoj që Aleanca ka qenë opozitë e mirëfilltë e kësaj qeverie.

"Epoka e re": Nuk po shohim se opozita është fort e interesuar për zgjedhje të reja, pavarësisht

prej kritikave që i jep për këtë pushtet. A është e gatshme AAK-ja për zgjedhje të reja?

Nitaj: Nuk besoj që ka një parti politike që thotë nuk jemi të gatshëm për zgjedhje. Opozita mund të mos jetë e kënaqur me pushtetin, siç nuk është sot, por kompleksiteti i situatës politike e i sigurisë në vend e në rajon, nuk është në favor të zgjedhjeve. Qeveria reflekton e hutuar, por ajo nuk mund të 'dezertojë' nga përgjegjësitë që i ka marrë. Ajo duhet t'i kryej detyrat që i ka, sado të komplikuar qofshin ato. Ajo duhet të mbahet mend për "marrëveshjen e madhe për njohje të ndërsjellë me Serbinë"! Më pastaj shohim e bëjmë.

MË 28 NËNTOR TË GJITHË PO BËHEN PATRIOTË, O BACA ADEM, EDHE ATA TË 29 NËNTORIT!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Shkuan, hëngrën, pinë dhe...: Baca Adem, për së gjalli, kur doje ta dërgoje një porosi për proceset në Kosovë, Shqipëri apo ku jetonin shqiptarët, TI bashkëbisedojte me Heronjtë e Kombit dhe, kush ishte bektesh, e merrte vesh.

Në çaste të caktuara kur, kryesisht bëhesha nervoz dhe këtë e shprehja përmes shkrimeve, më thoshe: "Qetësohu, ulu në b.. sepse, me pyet nuk po na pyesin, me dëgjua nuk po dëgjojnë, prandaj do të vijë një kohë kur do të na vjen keq - gjynah për këta shokët tonë...". Ashtu ishte Bacë, pa asnjë përjashtim! T'i ngushtuan dhe pamundësuan shtigjet që të merresh me një politikë në dobi të Kombit dhe Atdheut, nuk të lejuan të bëhesh as deputet i Kuvendit të Kosovës, madje nuk të lejuan asnjëherë t'i drejtohesh Kombit nga foltorja e Kuvendit, as në raste ceremoniale e lëre më të bëhesh president sepse e dinin se nuk do të bëhesh asnjëherë kallauz për të tjerët. Në ndërkohë, nuk mbeti politikan, oborrtar, rrogëtar ndërkombëtar gjithsesi pa iu drejtuar delegatëve të Kuvendit të Kosovës që e pranonin si të ishte vetë Zoti i zotave, Zeusi. Ta bën një ceremoni varrimi që më mirë mos ta kishin bërë sesa që e bën ashtu duke e shndërruar vendin ku prehesh në përjetësi në parking të veturave dhe kamionëve, pa e mirëmbajtur fare, me barishte dhe baltë përreth. Po të mos ishte Arbërie Demaçi që e pastronte vendin, ai varr do t'u përngjante varreve të

nizamëve shqiptarë që varroseshin në Siri apo Egjipt, në kohën e Perandorisë Osmane, pa nam dhe pa nishan. Po të mos ishin Elmi Reçica dhe Jahja Lluka, të pamet kishin vendosur t'i bënin në ndonjë kafene të lagjes! Gjatë ceremonisë së varrimit, në atë platenë e improvizuar, së paku 80 % ishin që nuk e meritonin të ishin aty, jo që të kishin përkrahur apo respektuar ndonjëherë, por në çdo rast të sulmonin. Çfarë turpi! Ne si popull ramë në provim ditën e varrimit Tënd, Baca Adem. Nguteshim të përfundojë sa më shpejt e mos ta lëshojmë kohën për një makiato! Çfarë mungese respekti! E pastaj habitemi pse na erdhën punët si na erdhën!

Më 28 Nëntor të çdo viti edhe shqiptarët si dhe kosovarët me prejardhje shqiptare bëhen patriotë. Së paku një ditë brenda një viti! Këtë vit u mbajt mbledhja e përbashkët e Kuvendit të Shqipërisë dhe Kuvendit të Kosovës në Tiranë sepse ishte 110-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë. Kësaj mbledhjeje i parapriu një prelude me valle shqiptare dhe me një ikonografi kombëtare sikur në fshatrat e Potemkinit. Disi m'u kthye në kujtesë një rast kur Mihajllo Zviceri dhe Hajredin Hoxha ishin në Tiranë në stadiumin "Qemal Stafa" ku, për hir të delegacionit nga Kosova, Ansambli i Këngëve dhe Valleve kishte përgatitur një program me artistë më të merituar të kohës si dhe valltarët e famshëm në krye me Hajredin Çelikut. Hajredini nga Kosova, i mësuar me vallet

jugosllave, sikur: "Shiri kollo, shiri kollo, kozaraçko llolo - luaje vallen, luaje vallen, bandill nga Kozara..." i entuziazmuar për çastin, i drejtohet Mihajllo Zvicerit me fjalët: "Çohu bre Mihajllo ta luajmë uzhiçko kollon - vallen e uzhiçes...". Disi kështu vepruan një numër i deputetëve të Kuvendit të Kosovës që ishin vazhdimësi e paraardhësve politikë dhe biologjikë, me mendësi jugosllave. O Baca Adem, ishin veshur si për Halloween, shtriheshin në ulëse sikur vezirët e Turqisë, me telefona para hundëve duke bërë selfie dhe duke bërë fotografi me të Atin e të Birin. Fitohej përshtypja se ishin ringjallur nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë të datës 28 Nëntor 1912! Ani kur filluan të flasin, nuk e dije se kush ishte Ismail Qemal më shumë se tjetri. O Bacë, problemin kryesor e kishin t'i lexonin tekstet që ua kishin shkruar të tjerët. Po të mos ishte një deputet turk, Enis Kervan, që e pati fjalimin më të mirë dhe që e lexoi në gjuhën shqipe më mirë se vetë shqiptarët, horën e dynjasë ishim bërë! U përmendën emra dhe mbiemra të figurave të merituar dhe aspak të merituar, si nga folësit shqiptarë e që shquheshin për gojëtarë ashtu edhe nga kosovarët me prejardhje shqiptare, mirëpo vetëm Glauk Bin Sherifi ta përmendi emrin duke të marrë shembull për atdhedashuri. Albin Bin Zaimi përmendi shumë emra, por nuk iu kujtonte në ato çaste! Duket se angazhimet dhe "përgjegjësitë" e

mëdha e kanë bërë një humbamento. Edi Rama i pati dy pika referuese për lirinë e Kosovës e që shkojnë bashkë sikur nata me ditën, atë të Ibrahim Rugovës dhe të Adem Jasharit! Nuk jam i sigurt se ka dëgjuar ndonjëherë për Adem Demaçin! Edi Rama, si artist mbi trapez, po ekuilibron - manipulon për mrekulli, kurdo që ka nevojë me Ibrahim Rugovën dhe Adem Jasharin! Këtë në Kosovë po mundohet ta bëjë Albin bin Zaimi duke vizituar, në baza të rregullta, varrin ku është Rugova, bashkë me Vojsa Osmanin, ndërsa gjatë kthimit marrin në thua në vendin ku prehesh në përjetësi, Baca Adem. Mbase që terreni është gunga-gunga! Edhe në Kosovë nuk kam dëgjuar, përveç shokëve të sinqertë dhe besnikë, të të përmendin përveç kur shënohet përvjetori i kalimit Tënd në Përjetësi! Edhe aty shfaqin ndjenja të rreme, falsitet i gërditshëm!

Në Lagjen Kodra e Trimave u përurua Pllaka Përkujtimore në shtëpinë ku jetoi dhe veprroi Heroi i Kombit Shqiptar, Xhavit Haziri. Pati njerëz mjaftueshëm, shokë të Xhavitit, ish-të burgosur politikë, idealistë që i mbijetuan materializmit, ish-luftëtarë të UÇK-së dhe disa shokë që i pate besnikë gjatë tërë kohës. As aty askush nuk e përmendi emrin dhe veprën tënde që ishte frymëzim për të gjithë idealistët që e donin lirinë sikur që ishte edhe vetë Xhavit Haziri, tash në piedestalin e Lavdisë së Përvjetshme. Bacë, në atë kohë, unë si sekretar i

KMDLNj-së, me rekomandimin tënd dhe të Nuhiut e pranua Xhavitin në punë për t'i siguruar kushte dhe mundësi që aktivitetin ilegal, si një ndër kryesorët në UÇK, ta legalizojë përmes angazhimit të rregullt në KMDLNj. Askush nuk e përmendi as këtë! Nuhi Ahmeti e kishte ruajtur flamurin kombëtar 40 vjet, flamurin para të cilit ishte betuar Xhavit Haziri dhe këtë flamur e shpalsi Avdullah Dërguti, i preferuari i Bacës Adem për aktivitete të caktuara, shumë specifike. Kishte përfaqësues nga Maqedonia e Veriut, Lugina e Preshevës dhe Ilirida. Përfundoi edhe kjo punë!

Lëmshi po ç' thuret duke na u bërë lak në fyt: Ata që e sollën lirinë sot janë në Burgun e Hagës. Ata që e bënë shtetin, kështu si është po mbahen si pengje në Burgun e Hagës për kënaqësi të disa partive dhe politikanëve që janë në pushtet dhe opozitë! Patriotët e vërtetë sot në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Luginë, Mal të Zi dhe në diasporë i kanë tri pika referuese për pelegrinazh; Vlorën në Shqipëri, Prekazin në Kosovë dhe Burgun në Hagë. Patriotët në Kosovë sot janë pakicë absolute, minoritet, me një fjalë. Jemi shndërruar thuaja në jashtëtokësorë, ashtu na konsiderojnë disa në pushtet dhe në opozitë! Na kërcënojnë pse ende jemi shqiptarë dhe nuk e pranojmë një krijesë parapolitike si janë kosovarët! Adem Demaçin mundohen ta varrosin shtatë

pashë nën dhe kurse Adem Jasharin e përdorin si joker kur kanë nevoja politike për marrje të pushtetit. Thonë se ishte koha për një president nga familja Jashari kurse e zgjedhin Vojsa Osmanin. Ani, flitet se Vojsa Osmani është nga trangu i Adem Jasharit, diku brezi i 137, sikur që jam unë me Ernest Heminguejn! Prej politikanëve madhorë, burrështetasit e burgosur në Hagë janë vizituar, kryesisht nga ish politikanë të rangut të lartë nga Kosova, Shqipëria dhe viset tjera shqiptare. Një pjesë e tyre e kishin vizituar edhe Zelenskin në Ukrainë. Nga aktualët në Kosovë, vetëm Glauk Bin Sherif i vizitoi të syrgjynosurit e Hagës pas së cilës e shkrepri një plumb kundër Gjykatës por se duket ka harruar ta rimbushë armën, i ka mbetur vetëm si trofe i një vizite të paralajmëruar, për t'i hapur rrugë vizitës së Albin bin Zaimit. Duket se, më në fund edhe Albin Bin Zaim do t'i vizitojë pengjet e Hagës dhe, sipas informatave që i kam edhe pengjet e Hagës do të mirëpresin këtë vizitë! Dhe këtu merr fund burrëria!

Po, baca Adem sigurisht se të intereson si i kemi punët në Kosovë?! Llugë dhe lëmsh! Vuçkoja po luan në tokën e Kosovës, me mall të Kosovës sikur të ishte në Shumadi apo Kragujevc. Targat ilegale po e vazhdojnë rrugëtimin

deri në kohën kur duan serbët si dhe ndërkombëtarët. U luajt një lojë e ndyrë me targa në emër të shtetshtrirjes së sovranitetit. Kurse, në fakt aty u shtri një sofrabez mbi të cilën do të vendoset Zajebnica si pjesë e një propozimi franko - gjerman ku ka Zajebnicë por nuk ka njohje reciproke duke lënë se pas 10 vjetëve, nëse shelja bën rrush, Serbia do ta njohë Kosovën e pavarur dhe sovranë. Serbët e veriut në polici, doganë, gjyqësi, administratë etj. dhanë dorëheqje duke nënshkruar kontrata me Vuçiqin, Daçiqin dhe Petkoviqin. Hynë e dalin sikur të ishin në bahçen e babës Zhivadin të Nishit kurse ne, ngaqë lakmia për të mbetur dhe ardhur në pushtet dhe për t'ua ngrohur prapancën ndërkombëtarëve, pranojmë çdo gjë duke kërkuar rrugë për kthimin e tyre në vendet e punës ndonëse, nëse nesër paraqitet nevoja përsëri do t'i lëshojnë vendet e punës për t'u kthyer kur t'iu çohet! Gjermania dhe Franca po na bëjnë presion ta pranojmë propozimin e tyre ndonëse ky propozim, në emër të trojkës negociuese ku ishte edhe Harçenko i Rusisë, i njohur si propozimi i Ishingerit (propozimi i dy gjermanive - dy serbive) ishte refuzuar në mënyrë kategorike nga Të Persekutuarit e Hagës që këmbëngulnin vetëm për Pavarësi, fillimisht e Kushtëzuar!

Tash, Albin Bin Zaimi po thotë se ky propozim qenka bazë e mirëpër çka?! Ky është bulshiti propozim që, edhe pas vjetëve dhe pas dhjetë vjetëve tjerë nuk e bënë Kosovën shtet të pavarur dhe sovran por, me kërkthizën e ndrikullave franko - gjermane e lidhë nyje me Serbinë!

Pamja e jashtme do të jetë ashtu si duam ne, përmbajtja do të jetë në kundërshtim me statusin e një shteti të pavarur dhe sovran! I vetmi deri tani Memli Bin Milazimi tha se e ka parë këtë propozim dhe se asnjëri në Kosovë nuk duhet ta pranojë si të tillë! Në Qeverinë Kurti 2 Patriotizmin dhe Atdhedashurinë duhet ta kërkonim me një teleskop sepse kanë mbetur vetëm gjurmët. Edhe disa që e kanë trashëguar një bagazh patriotik këtë e kanë përdorur gjatë fushatës dhe për akomodim në pushtet duke u shndërruar në ndjekës të pashpirt të kundërshtarëve që nuk pajtohen me halucinacionet e tyre. Kjo Bacë është për fillim, më vonë të shkruaj gjërësisht. Është një i ashtuquajtur Grup Teknik, kryesisht nga mercenarë dhe përfitues të Luftës dhe të Paqes, që marrin rroga 3500 euro për muaj duke i përgatitur materiale Ajnshtajnit të politikës kosovare, me test të IQ, mbi 350, Besnik Muçiverces duke ia fyer

thelësisht inteligjencën dhe kontributin e madh kombëtar të pamohueshëmpër lirinë dhe pavarësinë e Mongolisë! Këtë personalitet parahistorik, Albin Bin Zaimi e ka bërë njeriun kryesor për bisedime për faktin se nuk e flet asnjë fjalë të vetme dhe se, në fund të baladës, ky do të sakrifkohet, pa asnjë mëshirë (edhe nuk meriton mëshirë) duke ia adresuar tërë përgjegjësinë e që realisht nuk e ka. Besnik Muçiverca nuk ka mundësi t'i bartë koçet e Albin Bin Zaimit e as t'i kuptojë skenarët që janë shkruar! Ka harruar ta ndërrojë dioptrinë, mbase!

Albin bin Zaimi është bërë miqësor dhe i afërt me opozitën, jo se ka ndonjë vlerësim apo konsideratë për të, por se i duhet për t'i pastruar rrobat e palara, për ta pranuar propozimin e Trojkës dhe për të fituar kohë derisa Serbia (kur të bëjë shelja rrush) ta njohë pavarësinë e Kosovës. Ky është edhe misioni i vizitës eventuale në Hagë sepse ka nevojë për përkrahjen e saj. Vetëvendosje nuk ka problem me LDK-në sepse kjo bindet (në emër të interesit të shtetit dhe ruajtjes së miqësisë së përjetshme me ndërkombëtarët, me amerikanët në radhë të parë) dhe se LDK-ja nuk ka kapacitet të pengojë zbatimin e marrëveshjes eventuale në terren. Në radhët e

PDK-së ka burra dhe gra që kurrë nuk do ta pranojnë një marrëveshje ku nuk ka njohje, kanë trashëgimtarë biologjikë që, në mos si ata, pa asnjë dyshim do ta kundërshtojnë një marrëveshje të tillë. Populli shqiptar, hiç këtu kosovarët me prejardhje shqiptare gjithmonë kanë gjetur mënyrë dhe gatishmëri për të kundërshtuar çdo marrëveshje që është në kundërshtim me interesat kombëtare dhe shtetërore, pa pyetur për çmim që duhet paguar. Kush ngutet, përmutet, thotë një urti popullore, që nuk buron nga Emanuel Kanti, por nga burrat e mençur të odave shqiptare, prandaj duhet refuzuar këtë presion për nguti që, pa asnjë dyshim, është shantazh klasik dhe i pacipë. Sikur që po bëhet loja me liberalizim të vizave, nuk ka targa, nuk ka viza! Nesër e njëjta mund të përsëritet, nuk ka marrëveshje në afat të caktuar dhe ashtu si po imponohet, nuk ka viza! LDK-ja po deklaron se po bëhet gati ta marrë pushtetin, por pa opozitën (PDK-në dhe AAK-në). Duket se paska vendosur të bëjë koalicion me LV-në. Vetëm në këtë mënyrë mund ta marrë një copë pushtet sikur që e ka Lista S'Guxo sot!

Është një rregull: kush nuk ka bartur turqi, nuk ia di as rëndësinë e lëmshit, i bërë nga leshi! Ta shohim!

Këtë vit në Kosovë janë raportuar 15 raste me HIV infeksion dhe dy raste me AIDS

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Më 1 dhjetor shënohet Dita Botërore e AIDS-it, ditë e cila në shumë pjesë të botës kalon duke mësuar dhe informuar popullatën lidhur me këtë sëmundje, njëkohësisht vazhdon të jetë një çështje me rëndësi globale e shëndetit publik. Kampanja për vitin 2022 zhvillohet me moton "Barazi".

Motoja "Barazi" është thirrje për veprim, është një nxitje për të gjithë që të punojnë për t'i adresuar pabarazitë dhe për të ndihmuar në përfundimin e AIDS-it. Kjo përfshin rritjen e qasjes, cilësisë dhe përshtatjen e shërbimeve për trajtim, testim dhe parandalim të HIV-it në mënyrë që të gjithë të marrin shërbime të nevojshme; dhe reformimin e ligjeve dhe praktikave që trajtojnë stigmën dhe përjashtimin me të cilin përballen njerëzit që jetojnë me HIV, grupet vulnerabile dhe të marginalizuara, në mënyrë që të gjithë të trajtohen me respekt.

HIV vazhdon të jetë një çështje e madhe globale e shëndetit publik, 38.4 milionë njerëz në mbarë botën jetonin me HIV në vitin 2021. 1.5 milion njerëz u infektuan rishtas me HIV në 2021. 650 000 njerëz vdiqën nga sëmundjet e lidhura me AIDS në vitin 2021. 28.7 milionë njerëz po përdorin terapinë antiretrovirale në vitin 2021. 84.2 milionë njerëz janë infektuar me HIV që nga fillimi i epidemisë. 40.1 milionë njerëz kanë vdekur nga sëmundjet e lidhura me AIDS që nga fillimi i epidemisë.



Kosova është ndër vendet me prevalencën më të ulët të HIV-it në mesin e popullatës së përgjithshme dhe prevalencë të ulët në mesin e popullatës kyçe: meshkujt që bëjnë seks me meshkuj (MSM), personat që

injektojnë drogë (PID) dhe punonjëset femra të seksit (PFS). Të dhënat ekzistuese dëshmojnë se Kosova nuk ka epidemi të generalizuar apo të përqendruar të infeksionit HIV. Që nga viti 1986 deri më 1 dhjetor të vitit 2022 në

Kosovë janë raportuar 157 raste me HIV dhe AIDS.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas gjinisë, numri më i madh i takon gjinisë mashkullore (76 për qind). Grupmosha më e atakuar është 25-34 vjeç (31 për qind) dhe

35-44 vjeç me 27 për qind. Deri më tani 51 persona kanë vdekur si pasojë e AIDS-it. Në vitin 2022 janë raportuar 15 raste me HIV infeksion dhe dy raste me AIDS, prej tyre 6 janë nga komuniteti MSM.

Kosova dhe Maqedonia e Veriut pritët ta thellojnë bashkëpunimin në bujqësi

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka pritur në takim homologun nga Maqedonia e Veriut, ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ljupčo Nikolovski, me të cilin ka diskutuar rreth mundësive të bashkëpunimit, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të sektorëve të cilët mbulojnë institucionet gjegjëse të cilat drejtohen nga dy ministrat. "U pajtuam ta thellojmë bashkëpunimin ndërinstucional e ndërshtetëror duke hartuar

projekte të përbashkëta ndërkufitare me qëllim të fuqizimit ekonomik të bujqve që jetojnë rreth zonës kufitare Kosovë - Maqedoni e Veriut. Njëherësh ramë dakord për shkëmbim të përvojave për hartimin e politikave, përafrimin e tyre me ato të BE-së, heqjen e barrierave jotarifore, rritjen e kontrollit kufitar me qëllim ruajtjen e sigurisë ushqimore, hartimin e përbashkët të politikave pyjore, si dhe krijimin e një grupi teknik-administrativ i cili do t'i bartë më tutje frerët e hartimit dhe implementimit

të marrëveshjeve që do të vijojnë mes institucioneve tona", u shpreh ministri Faton Peci pas takimit. Ai e ka falënderuar ministrin Nikolovski për vizitën, konstruktivitetin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë. Të dy ministrat u zotuan t'i kultivojnë marrëdhëniet miqësore që popujt e tyre kanë mes vete si dhe të hapin rrugë drejt forcimit të pozitës së bujqve të të dyja vendeve përmes shkëmbimit të praktikave më të mira që do t'ua lehtësojnë veprimtarinë bujqësore.



BQK-ja: Bankat komerciale për 10 muaj fituan mbi 120 milionë euro

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Bankat komerciale në Kosovë deri në fund të muajit tetor kanë arritur të sigurojnë një fitim prej 120.3 milionë eurosh. Sipas raportit "Sistemi financiar, tetor 2022" paraqitur nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), del se deri në këtë periudhë bankat kanë fituar 20 milionë euro më shumë krahasuar me vitin paraprak. Aty theksohet se të hyrat ishin 303 milionë euro, prej të cilave 214.9 euro ishin nga interesi.

Për sa iu përket shpenzimeve, BQK-ja thotë se nga janari bankat kanë harxhuar 105.4 milionë euro për gjëra administrative, ndërsa 21.2 kanë qenë shpenzime nga interesi. Derisa raporti i likuiditetit ishte 34.5 për qind. BQK-ja thotë se norma për kredi të reja është 6.2 për qind, nga e cila 6.3 për qind është për korporata jofinanciare, kurse për ekonomitë familjare është 6 për qind.

Norma mesatare e interesit në depozita është 1.5 për qind ose dallimi i normës kredi-depozita

4.7 pikë përqindje.

Kreditë e këqija, sipas raportit të BQK-së, aktualisht janë 2 për qind.

Aktualisht vlera e aseteve e të gjitha bankave komerciale është 6 miliardë e 465 milionë euro, ndërsa kapitali vetjak është 678.3 milionë euro.

Qytetarët e Kosovës ua kanë 4 miliardë e 268 milionë euro borxh bankave komerciale, mirëpo vlera e depozitave ka shkuar në 5 miliardë e 289 milionë euro.

Shumë më e madhe e kredive është e dhënë për korporatat jofinanciare në vlerë prej 2.6 miliardë eurosh, derisa për ekonomitë familjare është rreth 1.6 miliard euro.

Ndryshimi mesatar vjetor i kredive është 17.9 për qind. Për individët është 17.3 për qind, për bizneset 17.5 për qind dhe 82.7 për qind për korporatat e tjera financiare.

Aktualisht në tregun e Kosovës operojnë 12 banka komerciale, prej të cilave 9 janë me kapital të huaj. Numri i degëve të tyre 199, kurse këto banka kanë të punësuar 3 734 punëtorë.



Aprovohet rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKP

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën ka marrë vendime të rëndësishme. Në këtë mbledhje bordi ka aprovuar rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKP, planin vjetor të punës dhe performancës së AKP-së për vitin 2023, transaksionet e shitjes së aseteve përmes likuidimit nr. 60 si dhe ka aprovuar raportin e komisionit të banesave për shitjen e 27 banesave në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore në bazë të kërkesave të parashtruara

nga shfrytëzuesit legalë të tyre sipas procedurave ligjore në fuqi.

Në lidhje me procesin e likuidimit, bordi i AKP-së ka aprovuar inicimin e procedurave të likuidimit për ndërmarrje shoqërore/asete: Industria e Qeramikës KIS, Gjilan; "Gazela", Prishtinë dhe "Sirovina Banat", Prishtinë.

Bordi i AKP-së, po ashtu, u njoftua me raportet përfundimtare për NSh-të në likuidim: Kooperativa Bujqësore "Prapaçani" - KK Deçan dhe për N. Sh. "KB Kuqishtë" Pejë përderisa këto raporte përfundimtare dërgohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës


Supreme për aprovim dhe mbyllje të këtyre ndërmarrjeve.

Gjatë kësaj mbledhje u aprovuan edhe raportet e shpërndarjes së përkohshme për kreditorët e këtyre ndërmarrjeve: N. Sh. "Drita Hotel" Ferizaj; N. Sh. "Duhani" Prishtinë; N. Sh. "Shipad Komerc" Pejë; N. Sh. "XIQ Karaqeva" Kamenicë.

Gjatë këtij takimi të bordit menaxhmenti i AKP-së ka paraqitur raportin mujor të aktiviteteve për periudhën paraprake si dhe raportin mujor për N. Sh. "Brezovica", e cila është nën administrim direkt, ku janë duke u bërë përgatitjet për sezonin dimëror.



Sabina Hosenfelder: Fizika dhe feja përzihen në shumë fusha



Nga Killian FOX

Sabina Hosenfelder është një fizikante teorike gjermane. Ajo shkruan libra dhe drejton një kanal në YouTube (deri më sot me 618.000 abonentë) të quajtur "Science without the Gobbledygook". E lindur në Frankfurt, ajo studioi për matematikë në Universitetin Gëte dhe vazhdoi të fokusohet mbi fizikën e grimcave.

Doktoratura e saj eksplorozi mundësinë që Përplasësi i Madh Hadron, të prodhonte vrime të zeza mikroskopike. Sot është një studiuese në Institutin e Frankfurtit për Studime të Avancuara, ku drejton një grup që studion gravitetin kuantik. Libri i saj i dytë "Fizika ekzistenciale: Udhëzuesi i një shkencëtarit për pyetjet më të mëdha të jetës, doli në treg në muajin në gusht.

Pyetja e parë që u bëni fizikantëve që intervistoni në libër është "A jeni fetarë?" Po ju vetë?

Jam përpjekur që kur isha adoleshente që të isha një besimtare. Unë nuk u pagëzova që fëmijë sepse prindërit e mi ishin të dy ateistë. Por të gjithë miqtë e mi ishin të krishterë, ndaj kur u rrita shkoja me ta në Kishë. Dhe më pëlqeu disi. Të kënduarit gjatë meshës, aktivitetet shoqërore. Mendova t'i bashkohesha, por thjesht nuk mund ta bindja veten që të besoja se Zoti ekziston.

Ju nuk ishit e pasionuar pas fizikës në shkollë. Pse?

Për shkak të mënyrës se si mësohej. Ne detyroheshim të bënim eksperimente që ishin kryer në të kaluarën nga njerëz të tjerë, dhe më pas supozohej të bënim vetë një rindërtim të dobët të tezës së tyre. Më dukej shumë e mërzitshme. Nisa të interesohem vërtet për fizikën vetëm kur mësova se si funksionojnë ekuacionet diferenciale.

Duke studiuar fizikë në universitet, arrita të kuptoja se sa shumë mund të kuptosh natyrën përmes matematikës. Kjo është arsyeja pse unë nuk përshtatem me ndonjë fushë të veçantë të fizikës, pasi kam këtë qasjen e përgjithshme. Unë thjesht dua të di se për çfarë është e mirë matematika.

Çfarë ju nxiti që të shkruani librin?

Mesazhi kryesor që doja të përcillja ishte: ne po pikturojmë një panoramë shumë të njëanshme të fizikës në shkollat tona por edhe në shtypin shkencor. E paraqesim atë si një disiplinë shumë teknokratike, me shumë matematikë, me përsheptues grimcash etj. Por fizika prek edhe pyetje të mëdha ekzistenciale: Si funksionon universi? Si filloi gjithçka? Nga çfarë jemi krijuar?

Ju shkruani se shumë kërkime në fizikë, si hipotezat për universin e

hershëm, janë në fakt "feja e maskuar si shkencë nën maskën e matematikës". A mund ta sqaroni më mirë këtë koncept?

Ekzistojnë shumë fusha ku themelet e fizikës ndërthuren me atë të fesë. Por fizikanët nuk e vënë re këtë, sepse nuk po i kushtojnë vëmendje. Kjo sepse në përgjithësi ka një mungesë edukimi mbi filozofinë e shkencës. Për shembull, historia më e pranuar për fillimin e Universit është Big Bengu, dhe në një farë mase kjo është në fakt mënyra më e thjeshtë për të ekstrapoluar ekuacionet në të kaluarën.

Më pas mund të shtoni inflacionin, që është një fazë eksponenciale e zgjerimit; ose si Roxher Penrouz, ju mund ta bëni atë një univers ciklik. Por ndoshta ka pasur një kapërcim të madh, ose gjithçka filloi me përplasjen e membranave. Këto ide janë që të gjitha të mundura, pasi janë në përputhje me vëzhgimet që kemi. Por unë do t'i quaja ato shkencore, pra janë lloji i idesë që provat nuk thonë asgjë pro dhe kundër.

A është po aq e arsyeshme të thuhet se Zoti ose ndonjë fuqi tjetër më e lartë e krijoi Universin?

Kjo është një pyetje e vështirë. Ekziston një dallim midis tyre, në kuptimin që teorinë me të cilat punojnë fizikanët janë matematikore në natyrë, ndërsa hipoteza e Zotit nuk është matematikore.

Ju nuk merreni aq shumë me teorinë e multiverseve. Pse?

Kjo është një nga ato ide, të cilën unë do ta quaja as shkencore. Nëse doni të besoni se në botë ka pafund kopje juajat si individ, me disa ndryshime të vogla – pra se njëri prej tyre ndoshta ka fituar çmimin Nobel, dhe tjetri është bërë një yll i muzikës rock – ju mund ta besoni këtë nëse dëshironi, pasi nuk është në kundërshtim me asgjë që dimë. Por nga këndvështrimi shkencor, nëse doni të përparoni mbi kuptimin e ligjit natyror, do të thosha se është humbje kohe pikërisht për këtë arsye, sepse nuk mund ta provoni atë.

Pse disa gjigantë të fizikës, si Stefën Houking, arritën të besonin se po jetojmë në një multivers?

Unë kam disa supozime, por nuk kam mundësi ta pyes atë. Por nuk është vetëm Houking, ka shumë fizikantë të tjerë që e besojnë këtë teori. Mënyra se si ata arrijnë në përfundimin se multiversi duhet të ekzistojë, është se ata kanë një teori që parashikon disa gjëra që pajtohen me vëzhgimet.

Deri këtu jemi në rregull. Por pastaj ata kalojnë tek përfundimin, se për këtë arsye e gjithë matematika që shfaqet në këtë teori duhet të ekzistojë në njëfarë kuptimi. Por gjërat nuk funksionojnë kështu. Sepse nëse i cakton realitetin disa shprehjeve matematikore, nuk mund ta mbështesësh këtë me argumente shkencore.

Jeni shumë kërkuese kur vlerësoni punën e shkencëtarëve të tjerë. Cilët nga fizikantët aktualë vlerësoni më shumë?

Unë admiroj shumë Roxher Penrouz, që ka një mendje vërtet të mprehtë dhe ka bërë shumë gjëra të mahnitshme. Ai ka qenë i hapur në kritikën e tij ndaj disa prej tendencave në themelet e fizikës, përfshirë Teorinë e Fijeve. Dhe ai është i guximshëm, duke parashtruar disa ide – si për shembull mbi gravitacionin, se si ndërjegjja luan një rol në trurin e njeriut, apo universin ciklik. E gjitha është shumë origjinale.

Ju shkruat një opinion për "The Guardian" në shtator në lidhje me fizikantët që shpiknin grimca të reja, që provokoi shumë debate...

Argumenti im ishte se është një strategji e keqe shkencore të shpikësh pak matematikë, dhe pastaj të shpallim se duhet ta testojmë, kur nuk ka arsye pse ajo duhet të funksionojë. Ju mund të ndërtoni shumë nga ato lloje grimcash, dhe gjërat sërish nuk do të funksiononin.

Mjafton që të shihni se çfarë kanë prodhuar eksperimentet e 40 viteve të fundit. Po ashtu më shqetëson fakti që ne flasim gjithmonë për atë se si shkencën gjoja korrigjohet, por nuk duket se po ndodh. Ata thjesht po provojnë të njëjtën gjë përsëri. / The Guardian – Bota.al

Ne njerëzit e gënjejtmë veten se jemi Perëndi, në fakt do të jemi vetëm klone pa kërthizë



Nga Michel HOUELLEBECQ

Mua nuk më pëlqen vetja. Kam shumë pak simpati për veten time, dhe aq më pak vlerësim. Për më tepër, vetë personi im nuk më intereson shumë. Unë i njoh prej kohësh karakteristikat e mia kryesore, dhe përfundova duke ndjerë neveri për to.

Kur isha adoleshent, flisja për veten time, mendoja për veten time, mbushesha me personin tim; sot nuk është më kështu. Jam larguar nga mendimet e mia, dhe vetëm ideja e të treguarit një episod personal më detyron të zhytem në një mërzë aq të madhe, sa që duke sikur jam pranë një gjendjeje kataleptike.

Nëse kjo gjë është absolutisht e detyrueshme, atëherë gënjej. E megjithatë paradoksalisht nuk jam penduar asnjëherë që jam riprodhuar. Mund të thuhet gjithashtu se e dua djalin tim, dhe e dua akoma më shumë sa herë që dalloj tek ai një gjurmë të defekteve të mia të shumta.

I shoh ato të shfaqen me kalimin e kohës me një lloj determinizmi të pamëshirshëm, dhe jam i lumtur për këtë. Më pëlqen pa më të voglin turp të shoh përsëritjen e tipareve të mia personale, dhe rrjedhimisht të përjetësuar, që nuk kanë absolutisht asgjë të dukshme. Karakteristika që janë shumë të neveritshme; dhe që në realitet nuk kanë asnjë meritë tjetër përveç asaj që janë të miat. Gjithsesi, ato nuk janë saktësisht të miat. Për disa prej tyre arrij të

kuptoj se e kanë origjinën në personalitetin e babait tim, gjë që çuditërisht nuk ma heq gëzimin.

Kjo ndjenjë është diçka më shumë sesa egoizëm; është diçka më e thellë dhe më e padiskutueshme. Si vëllim është diçka më shumë se sa projekcioni i tij mbi një sipërfaqe të sheshtë; ose si një trup i gjallë është më shumë se hija e tij. Përkundrazi, ajo që më trishton tek djali im, është fakti që e shoh të nxjerrë në pah (Ndikimi i nënës? Ndryshimi i kohërave? Individualizëm i pastër?) tiparet e një personaliteti autonom, në të cilin nuk e njoh fare veten time, që mbetet i huaj për mua.

Por në vend se të mrekullohem, e kuptoj se do të lë pas vetëm një imazh të paplotë dhe të dobësuar të vetes time. Brenda pak sekondash, ndjej më qartë aromën e vdekjes. Dhe mund ta konfirmoj: vdekja kundërmon. Filozofia perëndimore vështirë se e favorizon shfaqjen e ndjenjave të tilla.

Këto janë ndjenja që nuk i lënë vend përparimit, lirisë, individualizimit, të ardhmes. Ato i drejtohen vetëm përsëritjes së përjetshme e të paqartë të së njëjtës. Për më tepër, nuk kanë asgjë origjinale; ndahen nga pothuajse i gjithë njerëzimi, si dhe nga shumica e mbretërisë së kafshëve.

Ato nuk janë asgjë më shumë, se sa kujtesa gjithnjë aktive e një instinkti biologjik dominues. Filozofia perëndimore është një pajisje trajnimi e ngadaltë, e durueshme dhe mizore, e krijuar

për të na bindur mbi disa ide krejtësisht të rreme. E para prej tyre, është se ne duhet t'i respektojmë të tjerët pasi ata janë të ndryshëm nga ne. E dyta është se ne kemi diçka për të fituar nga vdekja.

Sot, për shkak të teknologjisë perëndimore, kjo "bojë e komoditetit" po del me shpejtësi. Sigurisht, unë do të klonohem sa më shpejt që të jetë e mundur. Të gjithë do të klonohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Unë do të shkoj në Bahamas, Zelandën e Re apo Ishujt Kajman.

Do të paguaj koston e nevojshme (as imperativët etikë dhe as financiarë nuk kanë peshuar ndonjëherë më shumë, krahasuar me ato të riprodhimit). Unë ndoshta do të kem dy ose tre klone, siç mund të keni ju 2 apo 3 fëmijë; ne lindjen e të cilëve do të respektoj një interval të përshtatshëm (as shumë afër dhe as shumë larg).

Duke qenë një burrë i pjekur, do të sillem si një baba i përgjegjshëm. Do t'u siguroj një edukim të mirë kloneve të mia; dhe në fund do të vdes. Do të vdes pa asnjë kënaqësi, pasi nuk dua të vdes. Megjithatë, derisa të vërtetohet e kundërta, jam i detyruar që ta bëj këtë. Përmes kloneve të mia, do të kem arritur një formë të caktuar mbijetese që nuk është aspak e mjaftueshme, por në çdo rast më e lartë se ajo që do të më kishin garantuar fëmijët. Është më e mira që mund të më ofrojë deri tani teknologjia perëndimore.

Në momentin e shkrimit të këtyre rreshtave, e kam të pamundur të

parashikoj nëse kloneve të mia do të lindin nga barku i nënës. Ajo që duket teknikisht e thjeshtë për njeriun laik (shkëmbimet ushqyese në placentë, janë më pak misterioze sesa akti i fekondimit), rezulton në fakt të jetë elementi më i vështirë për t'u riprodhuar.

Në rast se teknika rezulton të jetë mjaft e avancuar, fëmijët e mi të ardhshëm, kloneve të mi, do të përjetojnë fillimin e ekzistencës së tyre në një epruvetë qelqi. Dhe kjo më trishton pak. Nëse do të zhvillohen brenda një epruvete, kloneve të mia natyrshëm do të lindin pa kërthizë. Nuk e di se kush e përdori për herë të parë shprehjen 'littérature nombriliste' (letërsi e kërthizës) në një kuptim përçmues. Por e di që nuk më ka pëlqyer kurrë kjo klishe banale. E cili do të ishte interesi i një letërsie që pretendon të flasë për njerëzimin, duke përjashtuar çdo konsideratë personale? Qeniet njerëzore janë shumë më të ngjashme me njëri-tjetrin nga sa mund ta mendoni.

Në pretendimet e tyre komike se janë vetvetja, është shumë më e lehtë të mendosh të arrish universalen duke folur për veten. Dhe këtu shfaqet paradoksi i dytë: të flasësh për veten është një aktivitet i bezdisshëm, madje i neveritshëm. Të shkruarit për veten është në letërsi e vetmja gjë që ka rëndësi, në një masë të tillë që vlera e librave të jetë saktësisht proporcionale me kapacitetin për përfshirje personale të autorit të tyre.

Është groteske, madje e paturpshme po të doni, por kështu

është. Në fakt duke shkruar këto rreshta, jam duke menduar për kërthizën time. Zakonisht mendoj rrallë për këtë gjë, dhe është shumë më mirë. Ajo mbart qartazi në vetvete shenjën e një prerjeje, të një nyje të bërë me nxitim.

Është kujtimi i një prerjeje gërshtëresh, përmes së cilës u projektua hyrja ime në këtë botë. Dhe ashtu si unë, as ju nuk do t'i shpëtoni këtij kujtimi. Edhe kur të jeni shumë të moshuar gjurmën e asaj prerjeje, do ta ruani të paprekur në mesin e barkut.

Nga ajo vrimë e mbyllur keq, organet tuaja më të brendshme do të jenë në gjendje të dalin në çdo moment dhe të kalojnë në atmosferë. Ju mund të hapni zorrët në çdo kohë, nën diell; dhe të vdisni një peshk i mbaruar nga një goditje e çizmes mbi shtyllën kurizore.

Nuk do të jeni i pari dhe as shembulli më ilustrues. Mos harroni fjalët e poetit: Si një peshk i ngordhur, i shkelmuar. Së shpejti do të keni të njëjtën fat: fëmijë pa rëndësi. Do të jeni si Perëndi, dhe kjo nuk do të mjaftojë aspak.

Kloneve tuaja nuk do të kenë një kërthizë, por do të kenë një 'littérature nobrilliste'. Edhe ju do të jeni nobrillistë; pra të vdekshëm. Kërthiza juaj do të mbulohet me yndyrë dhe do të jetë thënë gjithçka. Pas kësaj, mbi fytyrën tuaj do të hidhet dheu.

Shënimi: Michel Houellebecq, një nga shkrimtarët më të njohur sot në Francë dhe nëpër botë. | "Il Giornale" – Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enverti
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Eliminohet Gjermania, kualifikohen Japonia dhe Spanja

DOHA, 1 DHJETOR - Japonia dhe Spanja janë dy skuadrat që shkojnë më tej në Kupën e Botës, ndërkohë që Gjermania do ta shohë pjesën e mbetura, ashtu si Italia nga divani. Në një mbrëmje të çmendur Japonia fitoi 2-1 me përmbysje ndaj Spanjës, ndërkohë që "Pancerat" fituan 3-2, por që ishte e pamjaftueshme. Spanja kaloi shumë shpejt në avantazh. Në minutën e 11-të, Azpilicueta shërben një asistim perfekt në zonë për Alvaro Moratën, i cili me kokë arrin të shënojë. Japonia u kundërpërgjigj në pjesën e dytë me dy gola për 3 minuta. Në minutën e 48-të, Ritsu Doan përfiton nga një gabim i mbrojtjes spanjolle për të shënuar me një goditje të fortë në hyrje të zonës. 3 minuta më pas, Ao Tanaka realizoi golin e dytë pas një aksioni të gjatë në zonë, atje ku u desh dhe ndihma e VAR për të rishikuar më qartë aksionin. Në

minutat e mbetura Spanja nuk tentoi shumë që të rrezikonte duke lënë jashtë Botërorit një rival si Gjermania dhe duke shmangur përballjen me Kroacinë në fazën tjetër. "Pancerat" fituan 4-2 ndaj Kosta Rikës, në një ndeshje që dhuroi jo pak emocione. Gnabry zhbllkoi shifra në minutën e 10-të. Gjithsesi Kosta Rika përmbysi shifrat me Tejeda dhe Vargas në pjesën e dytë. Më pas Gjermania do të kundërpërgjigjej me tri gola të tjera. Havertz shënoi një dopietë personale dhe Fullkrug shënoi golin e fundit.

Maroku dhe Kroacia ecin tutje, eliminohet Belgjika

Maroku është kualifikuar si e para në grupin F të Botërorit të Katarit, pas fitores 2-1 ndaj Kanadasë. Ky triumf bën që ekipi

i Reraguit të ketë 7 pikë, më shumë se çdo skuadër në grup. Kanadaja kishte bërë gati valixhet që para disa ditësh (0 pikë) dhe sot luante pa presion. Kjo përfaqësuese vazhdoi me lojën e dobët, teksa pësoi dy gola brenda 22 minutash. Fillimisht ishte Ziyech që realizoi për marokenët, ndërsa dyfishimi i shifrave erdhi nga En Nesryri. Brenda pjesës së parë, Aguerd do "tundte" rrjetën e gabuar, duke bërë kështu që shifrat të ngushtohen. Fraksioni i dytë do ishte disi më i ekuilibrat, skuadrat u ruajtën shumë që të mos pësojnë dhe loja ishte e mbyllur. Botërori i Katarit ka një surprizë të hidhur tashmë, teksa Belgjika (katër pikë, vendi i 3-të) me yje e mbyll këtu rrugëtimin e saj në Katar, pas barazimit 0-0 me Kroacinë. Këta të fundit do vazhdojnë të jenë pjesë e kompeticionit, pasi pozicionohen në vendin e dytë me 5 pikë (grupi



F). Sfidat do niste me mjaft ritëm dhe ekipi i Dalic do ia dilte të fitonte një penallti me zgjuarsi, në minutën e 15-të. Gjithsesi, pas një rishikimi në sistemin VAR, 11-metërshi anulohet për pozicion jashtë loje. Sërish kroatët në sulm në të 54-tën, me Luka Modriq që provoi të gjente golin por u ndal vetëm në fund nga pritja e Courtouis.

Mundësi e artë për të besuarit e Roberto Martinez në minutën e 60-të, por Romelu Lukaku bën më të vështirën, duke nxjerrë topin jashtë edhe pse porta ishte e boshatisur. Rezultati do ishte i pandryshuar deri në fund, me Belgjikën që zhgënjën totalisht dhe duhet të nisë gjithçka nga e para. Ky është fundi i këtij brezi të "djajve të kuq" dhe jo aq i bukur.

Prishtina triumfon kundër Bashkimit



Prishtinë, 1 dhjetor - Sigal Prishtina shënoi fitore ndaj Bashkimit në Prizren me shifrat 66:73 (17:10, 17:19, 18:17, 14:27), në një përballje shumë interesante dhe në dhjetë minutat e fundit ishin më të mirë, duke regjistruar fitore shumë të vlefshme. Ndeshja ishte në kuadër të javës së 12-të të Prince Caffè Superligës. Pas një fillimi të barabartë, prizrenasit me një seri prej 9:0, shkëputen në 17:7, ndërsa

çerekun e parë e fitojnë 17:10. Periudha e dytë ishte më e barabartë, ku prizrenasit tentonin rikthimin dhe prizrenasit që ruanin epërsinë, ndërsa pjesa e parë përfundon 34:29. "Bardhekaltrit" në periodën e tretë barazuan shifrat në 34:34, por sërish vendasit kishin shtatë-tetë pikë epërsi, ndërsa më pas riktheheshin kryeqytetasit për të ngushtuar rezultatit, kurse shifrat në semafor pas 30 minutash ishin

52:46. Në dhjetë minutat e fundit prizrenasit shkëlqyen dhe në momentet vendimtare ishin më të mirë, duke triumfuar në fund 66:73. Te Bashkimi u dalluan Daniel Lekndreaj me 13 pikë e 11 kërcime dhe Curtis Jones me 22 pikë, kurse te Sigal Prishtina më të miri ishte Dustin Thomas me 16 pikë e 11 kërcime. Prizrenasit kanë katër fitore e tetë humbje, kurse prizrenasit tetë fitore e katër humbje.

Dallasi triumfon ndaj Golden State

DALLAS, 1 DHJETOR - Dallasi ringrihet kështu pas katër humbjeve dhe këtë e bën duke mposhtur kampionët në fuqi. Për "Warriors" nuk mjaftoi Stefën Kërri, autor i 32 pikëve, 5 asistimeve dhe 5 ribaundeve, ndërsa Golden Stejt pësoi disfatë pas tri sukseseve. Nju Jorku mori një fitore të thellë në transfertë ndaj Detroit në shifrat 140-110, sukses që i mban

"Knicks" në garë për zonën "play-off", ndërsa "Pistons" zhyten edhe më shumë në vendin e fundit në Lindje. Një ndeshje pa histori, e dominuar tërësisht nga miqtë, ku protagonistin kryesor ishte Randwll, autor i 36 pikëve, 7 ribaundeve dhe 5 asistimeve. Klipers gjithashtu siguruan fitore jashtë fushe kundër Portland me rezultatit 118-112.

Një takim ky skuadra nga Los Anxhelosi realizoi një përmbysje të bukur, duke rikuperuar 18 pikë disavantazh. Pauell me 32 pikë ishte më i miri për Klipers, ndërsa për vendësit nuk mjaftuan Simons dhe Grant, respektivisht me 37 e 32 pikë. Për sa u përket kryesuesve, në Lindje udhëheq Bostoni, ndërsa në Perëndim në vend të parë pozicionohet Feniks.



Messi: Nuk kam pse kërkoj falje, pasi ishte vetëm keqkuptim

Doha, 1 dhjetor - Ditët e fundit Saul "Canelo" Alvarez, kampioni meksikan i boksit, kërcënoi Lionel Messin, duke e fajësuar se

ka shkelur fanellën e Meksikës për të pastruar dyshtemenë e dhomës së zhveshjeve pas fitores ndaj meksikanëve.

Siç shihet edhe në videon e festimet e postuara nga Nicolas Otamendi në rrjetet sociale. Tashmë ka ardhur përgjigja e yllit argjentinas, i

cili saktësoi: "Ka qenë një keqkuptim. Ai nuk më njeh. Nuk kam pse të kërkoj falje sepse nuk kam respektuar meksikanët apo fanellën".





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

PRESDNIK OPŠTINE

01Br.464/01-53706
Dana:30.11.2022

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4 i člana 10 zakona Br.03/L-139 Ekspropriaciju nepokretne Imovine, Službene Novine Republike Kosova, Br.52/08 Maj 2009 promene i dopune obavljene sa Zakonom Br.03/1-205, Službene Novine Republike Kosova, Br. Nr.91/10 Decembar 2010, stavova člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 Službene Novine Republike Kosova, Nr.20/21 Juni 2016, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt 24.12.2021, Predsednik Opštine Lipljan donosi:

PRELIMINARNA ODLUKA

I.USVAJA SE ekspropriaciju nepokretne imovine Katastarku Zonu Lipljan, prema listi sa ovom Odlukom, za dostizanje legitimnog dobijanja, za izgradnje centralnog gradskog parka i podzemnog parkinga u Lipljanu.

II. Preliminarna Odluka se dostavlja identifikovane lica u zahtevu, u roku od (5) radnih dana.

III. Odluka stupa na snazi dana objavljivanja u Službene Novine Republike Kosova i objavljivanja iste u neku novine sa većim tiražem na Kosovo.

IV. Protiv ovog preliminarne Odluke ili bilo kog njenog dela unutar petnaest (15) dana nakon stupanja na snazi, ima pravo da podnese žalbu na Osnovnom Sudu u Prištini-ogranak Lipljan svaki individ koji je vlasnik ili vlasnik interesa u imanju koje dotiče Preliminarna Odluka, ili koji ima mišljenje da ova Odluka je sporno sa jednim ili više uslove određenih u stavu 1 člana 4, u skladu sa članom 35 Zakona Br.03/L-139 za Ekspropriaciju Nepokretne Imovine sa promenama dopunama sa Zakonom Br.03/1-205 dt.28 oktobar 2010 (Službene Novine Republike Kosova Br.91).

V. Za sprovođenje ove Odluke obavezuju se: Kancelarija Predsednika-Pravno Imovinski Sektor, Direktor Urbanizma Planiranje i Zaštite Sredine, Direktorat Budžeta i Financije Direktor Geodezije i Katastra i Direktor za Infrastrukturu.

VI. Deo ove Preliminarne Odluke je detalna opisna lista katastarskih parcela iz tačke I ove Odluke.

Dostaviti:
-Svim Direktoratima
-Opštinskoj Arhivi

PRESDNIK OPŠTINE
Imri Ahmeti



Page 3 of 3

Detaljni opis katastarski parcela prema certifikate-katastarske jedinice za ekspropriaciju

Nr.	Vlasnik	K.K. Lipjan Staro Stanje			K.K. Lipjan Novo Stanje		
		Kadastralna Parcela	Kultura-klasa	Površina m ²	Vlasnik	Kadastralna Parcela	Površina Ekspropriacija m ²
1.	Shaban Reçica (Osman)	P-71409044-01740-1 ZK Lipjan	Njiva kl.1	433m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	433 m ²
2.	Xhevdet Sadiku (Shaip)	O-71409044-01747-0-46-1-1-0 ZK Lipjan	Bodrum	22.05 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	22.05 m ²
3.	Xhevdet Sadiku (Shaip)	O-71409044-01747-0-46-1-4-0 ZK Lipjan	Stan	52 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	52 m ²
4.	Xhevahire Salihu	O-71409044-01747-0-46-1-5-0 ZK Lipjan	Stan	39 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	39 m ²
5.	Rahmete Emimi	O-71409044-01747-0-46-1-7 ZK Lipjan	Stan	62 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	62 m ²
6.	Sami Krasniqi (Ihalim)	O-71409044-01747-0-46-1-2-0 ZK Lipjan	Stan	42 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	42 m ²
7.	Rufije Sadiku (Rrahman)	O-71409044-01747-0-46-1-1-0 ZK Lipjan	Stan	52 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	52 m ²
8.	Avdi Jashanica (Kadri)	O-71409044-01742-3-128-2-2-0 ZK Lipjan	Stan	52 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	52 m ²
9.	Avdi Jashanica (Kadri)	O-71409044-0128-2-BI-0 ZK Lipjan	Bodrum	10.49 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	10.49 m ²
10.	Burim Limani (Bajrush)	O-71409044-01742-3-128-1-1-0 ZK Lipjan	Stan	49 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	49 m ²
11.	Burim Limani (Bajrush)	O-71409044-0128-1-BI-0 ZK Lipjan	Bodrum	10.76 m ²	Opština Lipjan	parka i podzemnog parkinga	10.76 m ²

Page 2 of 3

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albina Dumnica B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330445842.

- Agron Merovci nga Vushtrria shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme Bujqësore tash "Avdyll Frashëri" drejtimi Veterinë.

- Sahit Kurhasku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. "Ali M. Hasi" Crmjan KK Gjakovë nga kl.I-VII.

- Avdullah Guta nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Artan Rrahmani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Auto Mekanik.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L